



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2024:073408

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05715192

P.nr.98/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm-gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Elheme Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.I nga ..., rruga "...", për veprë penale Rrezikim i trafikut publik, të parashikuar nga neni 370 par.8. lidhur me par.6. dhe par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.734/2024, datë.29.04.2024, të cilin sipas autorizimit e mbronë Avokat Valdrin Behrami nga Prishtina, në shqyrtimin fillestar gjyqësor publik, të mbajtur me datë 20.05.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Rukije Sheshivari, të autorizuarit të dëmtuarit S.B sipas autorizimit Avokat Mehdi Geci nga Prishtina, të dëmtuarit S.B, mbrojtësit të akuzuarit dhe të akuzuarit, e në mungesë të dëmtuarve A.E dhe K.R, me datë.20.05.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë **21.05.2024** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: L.I, i biri i ... dhe i ..., mbiemri i saj i vajzërisë ..., i lindur me dt.... në ..., Komuna e Drenasit, ku edhe tani e ka vendbanimin rruga "...", me numër personal të letërnjoftimit ..., i pamartuar, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, punon ekonomist në Kompaninë Private "... Sh.P.K., me seli në Parkun e Biznesit në Korroticë të Epërme, Komuna e Drenasit, i gjendjës së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pagjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet një procedurë tjetër për ndonjë veprë penale.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me datë 13.12.2023, rreth orës 18:20, në rrugën Prishtinë-Pejë, saktësisht në fshatin Komoran, i akuzuari nga pakujdesia duke drejtuar veturën e udhëtarve të markës "Citroen" të tipit "C3", viti i prodhimit 2019, me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë të bardhë, pronë e "... Sh.P.K., me seli në Parkun e Biznesit në Korroticë të Epërme, Komuna e Drenasit, kishte vepruar në kundërshtim me Ligjin mbi Rregullat e Trafikut Rrugor 05/L-088, neni 53 dhe neni 232, ku kishte rrezikuar trafikun publik dhe kishte vënë në rrezik jetën e njerëzve, ashtu qe, deri sa ishte duke e drejtuar automjetin e lartëcekur, në rrugën e lartcekur, me të arritur në Komoran, derisa i dëmtuari S.B ishte në ulësen e shoferit në veturën e tij të markës "Peugeot", të tipit "107", viti i prodhimit 2011, me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë të zezë, në shiritin emergjent, ende pa filluar lëvizjen me veturë, në atë moment kishte arritur i akuzuari me veturën

e tij, dhe duke mos e respektuar shpejtësinë e lëvizjes, në mënyrë të pa kontrolluar dhe në mënyrë graduale nga shiriti i djathtë kishte kaluar në shiritin për ndalje emergjente, dhe me pjesën e përparme e kishte goditur veturën e markës “Peugeot”, të tipit “107”, viti i prodhimit 2011, me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë të zezë, në pjesën e prapme të anës së djathtë, ku si pasojë e kësaj fatkeqësie të komunikacionit, sipas akt ekspertimit mjeko-ligjor, të përpiluar me datë.16.02.024, nga ana e ekspertit mjeko ligjor Prof.Asoc. Dr.Flamur Blakaj: -i dëmtuari A.E (bashkëudhëtar në veturën e të dëmtuarit S.B), kishte pësuar dëmtime të rënda trupore, në formë të traumës së shumëfishtë, gjakderdhje në të dy mushkërit, thyerje shumëcopëshe e nofullës së sipërme dhe mollëzës së fytyrë, thyerje të kockave përreth syrit, gjakmbledhje nënlëkurore në kapakun e sipërm të syrit të djathtë, plagë shqyese në kapakun e sipërme dhe në mbi vetullën e djathtë, thyerje të kockave të fytyrës të tipit Le Forte I, II, III dhe thyerje të sinusit ballor të kokës dhe thyerje të kockës së hundës, këto dëmtime të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të furishëm si pasojë e aksidentit në trafik, këto dëmtime shoqërohen me pasoja të përhershme për shëndetin, -i dëmtuari K.R (bashkëudhëtar në veturën e të dëmtuarit S.B) kishte pësuar dëmtime të rënda trupore, në formë të ndrydhjës të indeve të buta të kokës dhe krahërorit, tronditje trunore, plagë shqyese në regjionin zverkor të kokës, këto dëmtime të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të furishëm si pasojë e aksidentit në trafik, këto dëmtime kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit, -i dëmtuari S.B, kishte pësuar dëmtime të lehta trupore, në formë të ndrydhjës të indeve të buta të kokës, qafës, barkut, krahërorit dhe regjionit i dorës, plagë shqyese në gjuhë dhe thyerje të dhëmbit 11, këto dëmtime të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të furishëm si pasojë e aksidentit në trafik, këto dëmtime kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit dhe i akuzuari L.I, kishte pësuar dëmtime të rënda trupore, në formë të grumbullimit të gjakut në zgavrën e barkur pas shqyerjes traumatike të pjesës sigmoidale të zorrës së trashë dhe mezosigmes, shqyerje e mezentoriumit, këto dëmtime të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të furishëm si pasojë e aksidentit në trafik, këto dëmtime shoqërohen me pasoja të përhershme për shëndetin.

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik, të parashikuar nga neni 370 par.8. lidhur me par.6. dhe par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj gjykata në vështrim të neneve 4,7,17,23,38,42,43,44,69,79 dhe 370 par.8. lidhur me par.6. dhe par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 359,360,364, 449 par.2.6. dhe par.3., 452 par.1. dhe 462 par.2. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i:

C A K T O N

DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE prej 6 (gjashtë) muaj.

Në bazë të nenit 44 par.1. të KPRK-së, pasi që gjykata ka caktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i akuzuari ka dhënë pëlqimin që dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të i zëvendësohet me dënim me gjobë.

Në bazë të nenit 44 të KPRK-së, gjykata i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit L.I në shumë prej 2.000 (dymijë) €, të cilin do të e paguaj në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar në ndalim në kohëzgjatje prej 2 (dy) ditë, dhe atë prej datës 13.12.2023 e deri më dt.14.12.2023, të akuzuarit do të i llogaritët në dënimin me gjobë.

Nëse i akuzuari L.I në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të e zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 98 (nëntëdhjetë e tetë) ditë.

Kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së.

Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do të zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siq parashihet në paragrafin 3 të nenit 43 të KPRK-së. E nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të pandehurit, në vend të shqiptimit të dënimit me burg, të e zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzetë (20) Euro gjobë, kjo mundësi e tillë e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.5. të KPRK-së.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 200 €, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej 20 €, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë.

Të dëmtuarit A.E nga ..., rruga "...", Komuna e Klinës, S.B nga ..., Lagja ..., Komuna e Klinës dhe K.R nga Klina, Komuna e Klinës, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike lidhur me kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale, udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.734/2024, datë.29.04.2024, ka akuzuar të akuzuarin për veprën penale Rrezikim i trafikut publik, të parashikuar nga neni 370 par.8. lidhur me par.6. dhe par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar gjyqësor me datë 20.05.2024, ku ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm Rukije Sheshivari, mbrojtësi i të akuzuarit dhe i akuzuari, ashtu siq e parasheh neni 240 par.1. të KPP-së.

Të dëmtuarit, ishin njoftuar për seancën e shqyrtimit fillestar, ashtu siq e parasheh neni 240 par.2. të KPP-së, për çka ka prova, ku i pranishëm ishte i dëmtuari S.B me të autorizuarin e tij Avokat Mehdi Geci, ndërsa nuk ishin të pranishëm të dëmtuarit A.E dhe K.R në këtë seancë.

Në bazë të nenit 240 par.7. nënpar.1. pika.1. dhe 2. të KPP-së, në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari e ka informuar të akuzuarin që ai mund të paraqes propozimet e mëposhtme, deri në datën e caktuar, e cila nuk mund të jetë më vonë se tredhjetë (30) ditë nga shqyrtimi

filleshtar dhe atë: 1.-çdo kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë në pajtim me nenin 243 të KPP-së dhe 2.- çdo kërkesë për hedhjen e aktakuzës në pajtim me nenin 244 par.1. të KPP-së. I akuzuari deklaroi se e ka kuptuar këtë të drejtë.

Në fillim të shqyrtimit filleshtar, gjyqtari e ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tij, ashtu siç e parasheh neni 241 par.1. të KPP-së. I akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar udhëzimet.

Gjyqtari ka çmuar se e drejta e të akuzuarit në mbrojtës është respektuar dhe se prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë në zbulimin e provave nga neni 239 të këtij Kodi, ashtu siç e parasheh neni 241 par.2. të KPP-së.

Në bazë të nenit 241 par.3. të KPP-së, Prokurori i Shtetit ka lexuar aktakuzën, duke përjashtuar pjesët e aktakuzës të specifikuar në par.3. të nenit 237 të këtij Kodi. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën. Në bazë të nenit 241 par.4. të KPP-së, pasi që gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të akuzuarit ia ka ofruar mundësinë të e pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari ka deklaruar se e pranonë fajësinë në tërësi në të gjitha pikat e aktakuzës, pastaj gjyqtari në bazë të nenit 242 par.2. të KPP-së, ka përcaktuar se: -1.-i akuzuari kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; -2.-pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i akuzuari dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve; -3.-pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe çdo provë tjetër, e paraqitur nga prokurori i shtetit dhe -4.-aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Në bazë të nenit 242 par.5. të KPP-së, gjatë marrjes në konsideratë të pranimit të fajësisë, gjyqtari i mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit, mbrojtësit të akuzuarit dhe të autorizuarit të dëmtuarit S.B, Avokat Mehdi Geci.

Ku prokurori i shtetit deklaroi: se pajtohet me pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit, deklaroi: se pajtohet me pranimin e fajësisë.

I autorizuari i të dëmtuarit S.B, Avokat Mehdi Geci, deklaroi se: meqenëse ne sot e pranuan aktakuzën, ndoshta ka mundur të jetë një gabim teknik, sepse i mbrojturi im i dëmtuari S.B, nuk ka pësuar lëndime të lehta, por ka pësuar lëndime të rënda trupore. Në bazë të raporteve mjekësore dhe ekspertizave mjekësore shifet shumë qartë se i dëmtuari S.B ka pësuar lëndime të rënda trupore, të cilat pasoja edhe sot është duke i vuajtur dhe duke i shëruar. Me pranimin e fajësisë pajtohem.

Të njëjtit deklaroi se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par.2. të KPP-së.

Në bazë të nenit 242 par.6. të KPP-së, pasi që gjyqtari u bind se janë vërtetuar çështjet nga par.2. të nenit 242 të KPP-së, mori aktvendim me të cilin miratoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari lidhur me veprën penale Rrezikim i trafikut publik, të parashikuar nga neni 370 par.8. lidhur me par.6. dhe par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe konstatoi deklarimet e të akuzuarit nga neni 242 par.2. të KPP-së.

Pastaj, në bazë të nenit 365 par.3. të KPP-së, gjyqtari mori aktgjykim, me të cilin të akuzuarin e shpalli fajtor për veprën penale Rrezikim i trafikut publik, të parashikuar nga neni 370 par.8. lidhur me par.6. dhe par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata menjëherë sipas detyrës zyrtare, sipas nenit 356 par.3. të KPP-së, mori aktvendim për caktimin e seancës për caktimin e dënimit pas shpalljes fajtor të akuzuarit L.I për veprën penale të lartëtheksuar, për të marrë informacione shtesë me rëndësi për caktimin e dënimit. Ku të pranishëm në seancën për caktimin e dënimit ishin: Prokurori i Shtetit Rukije Sheshivari, i autorizuari të dëmtuarit S.B, Avokat Mehdi Geci, i dëmtuari S.B, mbrojtësi i të akuzuarit Avokat Valdrin Behrami dhe i akuzuari L.I, ku palët e lartëcekura, në bazë të nenit 356 par.7. të KPP-së, kanë mundur të i paraqesin gjykatës: -1. çështjet për ashpërsim të dënimit, përfshirë të dhënat nga e kaluara kriminale e të akuzuarit; -2. çështjet për zbutje të dënimit, përfshirë edhe ato relevante për zbutje të dënimit nën minimumin e paraparë me ligj; -3. deklaratën ose argumentet për një dënim të përshtatshëm, qoftë me gojë ose me shkrim dhe -4. çështje tjera që gjyqtari i

vetëm gjykues ose trupi gjykues i konsideron të rëndësishme për caktimin e një dënimi të përshtatshëm.

Në bazë të nenit 356 par.8. të KPP-së, është përcaktuar se dispozitat e zbatueshme për radhën e paraqitjes së provave në shqyrtim gjyqësor zbatohen përshtatshmërisht gjatë seancës për caktimin e dënimit.

Në këtë seancë për caktimin e dënimit, Prokurori i Shtetit Rukije Sheshivari, deklaroi: gjykata si rrethanë lehtësuese me rastin e matjës së dënimit, të vlerëson pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata me rastin e marrjes së vendimit, të vlerëson rrethanat se i akuzuari ka shkaktuar aksident të komunikacionit, duke zhvilluar një shpejtësi të lëvizjes prej 107 km/h, dhe ka qenë me shpejtësi që ka ndikuar në shkaktimin e aksidentit të komunikacionit, ku lëndime trupore kanë pësuar personat që kanë qenë udhëtar të automjetit, të cilin e ka drejtuar S.B.

I autorizuari i të dëmtuarit S.B, Avokat Mehdi Geci, deklaroi se: pajtohem me fjalën e prokurorit.

I dëmtuari S.B, deklaroi se: pajtohem me fjalën e mbrojtësit tim. Deklaroi se, këtë nuk ma ka bërë me qëllim dhe nuk kemi asgjë të keqe.

Mbrojtësi i të akuzuarit Avokat Valdrin Behrami, deklaroi: gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit, duhet të i ketë parasysh këto rrethana, mungesën e dashjës për të kryer këtë veprë penale, pendesën e thellë dhe kërkimfaljen, të cilën i akuzuari nga fillimi i këtij procesi të cilën e ka shprehur, e veçanarisht pranimin e fajësisë në fazën fillestare të këtij procesi gjyqësorë. Për më tepër, i njëjti asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin dhe e ka një të kaluar të pastër, poashtu është mbajtës i familjes dhe e gjithë familja mvaret nga të ardhurat të cilat i njëjti i realizon në kompaninë, ku ai punon. Prandaj nga këto arsye, i propozojmë që kjo gjykatë ndaj të njëjtit të shqipton një dënim alternativë, qoftë me gjobë apo me kusht.

I akuzuari L.I,deklaroi: pajtohem në tërësi me fjalën e mbrojtësit tim, e kam pranuar fajësinë, gjykatës i premtoi se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale, pendohem shumë për veprën e kryer penale, i këroi falje të dëmtuarëve publikisht, dhe këtu të dëmtuarit të pranishëm S.B, shprehi keqardhje të madhe, edhe unë jam lënduar në këtë fatkeqësi të komunikacionit, ku jam ende në terapi, deklaroi se patentshoferin e kam prej vitit 2013 dhe gjatë kësaj periudhe, vetëm njëherë jam dënuar për kundërvajtje, kërkoi nga gjykata që të më shqiptoi një dënim sa më të butë

Duke i vlerësuar me ndërgjegje provat e nxjerrura në procedurë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, në bazë të nenit 7 par.1. dhe nenit 359 të KPP-së, gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjendjen e këtyre faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe nga provat dhe faktet që i përmban aktakuza.

Nisur nga këto fakte dhe prova të vërtetuara në procedurë, në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8. lidhur me par.6. dhe par.1. të KPRK-së, të cilën e ka kryer me pakujdesi të vetëdijshme, pasi qe ishte i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit të tij, por me mendjelehtësi ka menduar se ajo nuk do të shkaktohet apo se ky do të mundë ta parandalojë shkaktimin e saj.

I akuzuari e ka kryer këtë veprë penale, sepse në bazë të nenit 7 të KPRK-së, kjo veprë penale është veprë e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si veprë penale, tiparët e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Për këtë veprë penale është shpallur fajtor, sepse në përputhje me nenin 17 par.1. të KPRK-së thuhet se: kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia". Në rastin konkret i akuzuari këtë

vepër penale e ka kryer me pakujdesi të vetëdijshme sipas nenit 23 par.2. të KPRK-së, ku është paraparë sanksioni penal.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarin, pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin merr faktin se e ka pranuar fajësinë në tërësi, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar, nuk ka të dhëna se zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij, gjykatës i premtoi se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale, pendohet shumë për veprën e kryer penale, i kërkon falje të dëmtuarve, shpreh keqardhje të madhe dhe se vet në këët fatkeqësi të komunikacionit ka pësuar dëmtime të rënda trupore, ndërsa rrethana rënduese gjeti se në këtë fatkeqësi të komunikacionit shkalla e dëmit të shkaktuar tek i dëmtuari A. E është shumë e lartë dhe se kemi edhe dy të tjerë me dëmtime trupore. Andaj edhe pse për këtë vepër penale është i paraparë dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj e deri në 5 (pesë) vite, të njëjtit ia caktoi dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, pasi që gjykata ka caktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, në bazë të nenit 44 par.1. të KPRK-së, i akuzuari ka dhënë pëlqimin që dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të i zëvendësohet me dënim me gjobë, dhe gjykata njëkohësisht vendosi që dënimi me burg të zëvendësohet me dënim me gjobë, dhe i shqiptoi dënim me gjobë të akuzuarit në shumë prej 2.000 (dymijë) €, (nëse i akuzuari L.I në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 100 (njëqind) ditë, kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së), ku gjykata pati parasysh nenin 44 par.2. të KPRK, ku është përcaktuar se “kur dënimi më burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, gjykata nuk kufizohet me shkallën e përlllogaritjes të përcaktuar në nenin 43 par.3. të KPRK-së”. Me bindjen se dënimi me gjobë është në përputhshmeri të plotë me shkallën e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësin penale të akuzuarit, dhe se i njëjti dënim do të ndikoi që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmën dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarve për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin që koha e kaluar në ndalim në kohëzgjatje prej 2 (dy) ditë, dhe atë prej dt.13.12.2023 e deri me dt.14.12.2023, të akuzuarit të i llogaritët në dënimin me gjobë, gjykata e bazoi në nenin 79 par.1. të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e bazoi në nenin 450 par.1. nenit 452 par.1.lidhur me nenin 449 par.2.nënpar.2.1. të KPP-së, ashtu që e detyroi të akuzuarin që të paguaj gjithsejt shumë prej 200 € (në emër të shpenzimeve të ekspertit të komunikacionit shumë prej 150 € dhe në emër të shpenzimeve të ekspertit të mjekësisë ligjore në shumë prej 50 €).

Vendimin që i akuzuari të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 €, gjykata e bazoi në nenin 449 par.2.6. dhe par.3. të KPP-së, duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmerinë e procedurës dhe gjendjen financiare të të akuzuarit.

Vendimin që të detyrohet i akuzuari që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimin të paguaj taksën në shumë prej 20 €, gjykata e bazoi në nenin 36 par.3. nënpar.3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimin, ku është paraparë se gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuar në nën paragrafi 3.1. të këtij paragrafi caktojnë edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim: për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në shumë prej njëzet (20) €.

Vendimin që të dëmtuarit A.E nga Klina, rruga "...", Komuna e Klinës, S.B nga ..., Lagja ..., Komuna e Klinës dhe K.R nga Klina, Komuna e Klinës, lidhur me realizimin e kërkesës pasuroro juridike për kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale, të i udhëzoi në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 463 par.2. të KPP-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë të kësaj kërkesë.

Nga e lartëtheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.98/2024, datë:21.05.2024**

**Procesmbajtësja
Elheme Kastrati**

**Gj y q t a r i
Shefqet Baleci**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, personat e autorizuar (të paraparë sipas nenit 381 par.1. të KPP-së), kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë (e paraparë sipas nenit 374 par.1. nënpar.1.1. të KPP-së), në afat prej tredhjetë (30) ditëve (e paraparë sipas nenit 380 par.1. të KPP-së), duke llogaritur nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar si më lartë, e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit (e paraparë në bazë të nenit 380 par.3. të KPP-së).